



**BURSA STUDIMI NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK MARCHE
ANKONA ITALI
VITI AKADEMIK 2021-2022**

Sekretariati i Përhershëm i Iniciativës Adriatik Jon ofron 10 bursa dyvjeçare, të financuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë, të cilat do t'u jepen studentëve që vijnë nga rajoni Adriatik-Jonian dhe Ballkani Perëndimor për t'u regjistruar në një nga katër kurset e masterit, të cilat do të zhvillohen në gjuhën angleze në Universitetin Politeknik Marche në degët:

- Ekonomi dhe tregti ndërkombëtare;
- Inxhinieri biomjekësore;
- Inxhinieri mjedisore dhe inovacion;
- Menaxhimi i ushqimit dhe pijeve.

Në momentin e pranimit prej palës pritëse studentit i ofrohet bursë e cila arrin deri në 6.000,00 € (euro), bruto për të gjitha tarifat për llogarinë e përfituesit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është caktuar **data 8 nëntor 2021, ora 13:00**.

Në mënyrë që aplikimi të jetë i vlefshëm, duhet të ngarkoni në linkun e mëposhtëm dokumentet si vijojnë:

- Dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë);
- Curriculum vita;
- Letër motivuese;
- Lista e notave;
- Certifikatë e gjuhës angleze;
- Certifikata e ciklit të parë të studimeve;
- Letër referencë (fakultative);
- Çdo dokument tjetër të dobishëm për të vlerësuar përshtatshmërinë e kandidatëve (publikime, diploma, certifikata) sipas dëshirës.

Rekomandohet që dokumentet e mësipërme duhet të ngarkohen në formatin .pdf dhe të mos jenë më të mëdha se 5MB secila.

Detaje të tjera në lidhje me universitetin dhe mundësinë e aplikimit i gjeni në links e mëposhtëm:

https://univpm.elixforms.it/rwe2/module_preview.jsp?MODULE_TAG=Relazioni_int_iscr

<https://www.univpm.it/Entra/>